

**STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË
INFORMACIONIT GJEOPHAPËSINOR NË SHQIPËRI.
TEMA: INFRASTRUKTURA BUJQËSORE DHE AKUAKULTURA**

PËRMBAJTJA

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE	3
2. HYRJE.....	3
2.1. Qëllimi.....	3
2.2. Si lexohet dokumenti.....	3
2.3. Detyrimet ligjore	9
2.4. Fusha e veprimit	10
3. TEMA	12
3.1. Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura	12
3.1.1. Parathënie.....	12
3.1.2. Skemat e aplikimit dhe diagrama UML për temën “Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura”	15
3.1.3. Katalogu i tipologjisë	20
3.1.3.1. Ndërmarrje.....	20
3.1.3.2. Vendndodhje.....	22
3.1.3.3. Llojet e kafshëve të fermave.....	24
3.1.3.4. Vlerat e specieve të blegtorisë	24
3.1.3.5. Vlerat e specieve të akuakulturës.....	25
3.2. Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura – modeli i zgjeruar	26
3.2.1. Parathënie.....	26
3.2.2. Skemat e aplikimit dhe diagrama UML për temën “Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura – Modeli i zgjeruar”	26
3.2.3. Katalogu i tipologjisë	32
3.2.3.1. Ndërmarrje.....	32
3.2.3.2. Instalimet	34
3.2.3.3. Instalimet abstrakte.....	34
3.2.3.4. Instalimet e akuakulturës	36
3.2.3.5. Instalimet e menaxhimit të ujrave.....	38
3.2.3.6. Llojet e kafshëve të fermave.....	39
3.2.3.7. Ndërtesa bujqësore	40
3.2.3.8. Ngastër.....	41
3.2.3.9. Pjesa e instalimit.....	43
3.2.3.10. Vendndodhja	44
3.2.3.11. Gjendja shëndetësore e njohur	45
3.2.3.12. Vlerat e aktiviteteve të akuakulturës	47
3.2.3.13. Vlerat e aktiviteteve të ngastrave	47
3.2.3.14. Vlerat e burimeve ujore.....	48
3.2.3.15. Vlerat e instalimeve të akuakulturës	48
3.2.3.16. Vlerat e metodës së vaditjes.....	48

3.2.3.17.	Vlerat mjedisore	49
3.2.3.18.	Vlerat e llojeve të ndërtesave bujqësore.....	49
3.2.3.19.	Vlerat e pjesëve të instalimeve.....	50
3.2.3.20.	Vlerat e gjëndjes shëndetësore	50
3.2.3.21.	Vlerat e llojeve të blegtorisë	50
3.2.3.22.	Vlerat e specieve të akuakulturës	51
3.3.	Metadata	52
3.4.	Kodi EPSG për KRGJSH-në	52
3.5.	Cilësia e të dhënave	53
3.5.1.	Kompletimi – Përjashtimi (Completeness – Omission)	55
3.5.2.	Përputhja ligjore – Përputhja konceptuale (Logical consistency – Conceptual consistency).....	55
3.5.3.	Përputhja ligjore – Përputhja me domein-in (Logical consistency – Domain consistency)	56
3.5.4.	Saktësia pozicionale – Saktësia absolute ose e jashtme (Positional accuracy – Absolut or extrenal accuracy).....	57
3.5.5.	Saktësia tematike – Korrektësia e klasifikimit (Thematic accuracy – Classification correctness).....	58
3.5.6.	Cilësia kohore – Vlefshmëria kohore (Temporal quality – Temporal validity)	59
4.	ANEKSE	61
4.1.	Aneksi A – Katalogu i tipologjisë	61
4.2.	ANEKSI C - Kod listat.....	62
4.2.1.	Skema e aplikimit për temën “Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura”	62
4.2.2.	Vlerat e aktiviteteve të akuakulturës	62
4.2.3.	Vlerat e instalimeve të akuakulturës	63
4.2.4.	Vlerat mjedisore	64
4.2.5.	Vlerat e gjëndjes shëndetësore	65
4.2.6.	Vlerat e pjesëve të instalimeve.....	66
4.2.7.	Vlerat e metodës së vaditjes	69
4.2.8.	Vlerat e aktiviteteve të ngastrave	70
4.2.9.	Vlerat e llojeve të ndërtesave bujqësore.....	82
4.2.10.	Vlerat e burimeve ujore	89

1. PËRSHKRIMI I STANDARDEVE

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), në bashkëpunim me Axhencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), e cila është autoritet publik përgjegjës për temën “Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura”.

Data e publikimit të versionit nr. 1 është 10 Korrik 2019. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSIDI_2019_IBA_v.1 ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit

Standard – Lloji i dokumentit

NSDI – Qëllimi i dokumentit

2019 – Viti i krijimit

IBA – Tema për të cilën është krijuar standardi: “Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura”.

v.1 – Numri i versionit të standardit

2. HYRJE

2.1. QËLLIMI.

Ky dokument përcakton specifikimet teknike, për të dhënat gjeohapësinore të temës “*Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura*”, temë e cila është përcaktuar në nenin 11, pika 2/q, të ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky dokument publikohet si standard që përcakton rregullat bazë të implementimit të NSDI¹ në Shqipëri, me qëllim përdorimin e tij nga autoritetet publike përgjegjëse, për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e informacionit gjeohapësinor, që të arrihet një kuptueshmëri unike dhe korrekte e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore, për të realizuar ndërveprueshmërinë midis tyre.

2.2. SI LEXOHEM DOKUMENTI.

2.2.1. STRUKTURA E DOKUMENTIT

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë:

- 1- **Përshkrimi i standardeve:** – Në këtë pjesë jepet emërtimi dhe autori i standardeve.
- 2- **Hyrje:** – Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të interpretohet më lehtë ai.

¹ NSDI – Infrastruktura Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor

- 3- **Tema:**- Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për temën “Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura”.
- 4- **Anekse:** – Në këtë pjesë jepen informacione shtesë, shpjeguese, në ndihmë të përdoruesve.

• **Përmbajtja e Kapitullit të 3-të është strukturuar në 4 pjesë kryesore:**

- 3.1. **Përshkrimi i temës** – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës si dhe detajohen: **Diagramat UML dhe Katalogu i Tipologjive**.
- 3.2. **Përshkrimi i nëntemës së parë** – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e nëntemës si dhe detajohen: Diagramat UML dhe Katalogu i Tipologjive.
- 3.3. **Përshkrimi i nëntemës së dytë** – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e nëntemës si dhe detajohen: Diagramat UML dhe Katalogu i Tipologjive.
- 3.4. **Metadata** – Këtu jepen specifikimet teknike për metadata-t e temës përkatëse.
- 3.5. **Sistemi Koordinativ Referencë** – Këtu përcaktohet sistemi koordinativ referencë që është miratuar me vendimin Nr. 669, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar me vendimin nr. 322, datë 27.4.2016 dhe vendimin nr. 359 datë 29.05.2019.
- 3.6. **Cilësia e të dhënave** – Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementeve dhe matjes së tyre.

2.2.2. DIAGRAMAT UML DHE KATALOGU I TIPOLOGJISË

Diagramat UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementet kryesorë të specifikimeve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit gjeohapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në ‘Katalogun i Tipologjive’ (Feature Catalogue). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike, por nuk janë të familjarizuar me UML-në, mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave duke u fokusuar te Katalogu i tipologjive. Për përdoruesit e aplikacioneve, Katalogu i tipologjive, mund të jetë i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhëna të nevojshme për përdorim.

Në tabelat e mëposhtme shpjegohet përmbajtja dhe mënyra e organizimit të informacionit, në tabelat e të dhënave, në Katalogun e tipologjive.

Tabelat nr. 1, 2, me anë të shembujve, shpjegojnë mënyrën e organizimit të informacionit, në tabelën e tipologjive dhe të attributeve të tyre.

Tabela nr. 3, me anë të një shembulli, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit, në tabelën e kodlistës.

Tabela 1

Emri - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi	Përkufizimi për tipologjinë.
Përshkrimi	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Lloji i tipologjisë	Tipi i elementit që mund të jetë i këtyre llojeve: « featureType » - një element që mund të jetë real, në terren, apo një dukuri abstrakte

	<p>«dataType» - një element tabelor, që shërben vetëm si tabelë attributesh, për t'u lidhur me një element tjetër</p> <p>«enumeration» “Kodlist» - listë e parapërgatitur vlerash, ku elementi duhet të marrë vlerë. <i>Enumeration</i> nënkupton “renditje vlerash”, ndërsa <i>codeList</i> nënkupton listë vlerash ose ndryshe “kod listë”. Në dokument gjenden të shqipëruara si “Numërtimet dhe kod listat”.</p> <p>«union» - një mbulesë topologjike e dy ose më shumë grupeve të të dhënave gjeohapësinore, që ruan tiparet, të cilat bien brenda shtrirjes gjeohapësinore të të dy grupeve të të dhënave hyrëse.</p> <p>«Imported» - të dhëna të specifikuara në tema të tjera të Direktivës INSPIRE. Në dokument gjenden “Të dhënat e importuara”</p>
Gjeometria	<p>Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tri forma: pikë, linjë, poligon.</p> <p>Abstrakt – kur elementi nuk është element real në terren, por konsiderohet vetëm si dukuri.</p>
Shumëllojshmëria	<p>Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi:</p> <p>0..* - mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë</p> <p>1..* - mund të marrë minimumi 1 vlerë ose shumë vlera</p> <p>0..1 - mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme.</p> <p>1 - duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë</p>
I detyrueshëm	<p>Po – nëse atributi është i detyrueshëm të plotësohet</p> <p>Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet</p>
Rol shoqërimi	<p>Në tabelën e lidhjeve “Rol shoqërime” tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementeve të ndryshme në këtë temë, si dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.</p>

Tabela 2

ATRIBUTET
<p>-- Emri -- Emërtimi i atributit</p>
<p>-- Përkufizimi -- Përkufizimi i elementeve</p>
<p>-- Përshkrimi --</p>

ATRIBUTET
Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin [I detyrueshëm: Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë, p.sh: PO]

Tabela 3

ATRIBUTET
<p>◆ Vlera e parë e listës së gatshme, p.sh: Ligjor</p> <p>-- Emri -- Emërtimi i vlerës</p> <p>-- Përkufizimi -- Përkufizimi i elementeve.</p>
<p>◆ Vlera e dytë (etj.) e listës së gatshme, p.sh: Joligjor</p> <p>-- Emri -- Emërtimi i vlerës</p> <p>-- Përkufizimi -- Përkufizimi i elementeve.</p>

2.2.3. KARAKTERISTIKAT E <<VOIDABLE>> DHE SHUMËLLOJSHMËRIA

Stereotipi <<voidable>> përdoret për të përshkruar ato karakteristika të objekteve gjeohapësinore që mund të jenë ose mund të mos jenë të pranishme në grupet e të dhënave gjeohapësinore edhe pse mund të ekzistojnë në botën reale. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet t'u jepet një vlerë.

Për të gjitha karakteristikat, e përcaktuara për objektet gjeohapësinore, duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave), ose vlera 'void'. Një vlerë 'void' nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse, në grupet e të dhënave gjeohapësinore, që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese.

Arsyeja e përdorimit të vlerës 'void' duhet të paraqitet kurdo që të jetë e mundur, duke përdorur një nga vlerat e listuara në kod listën *VleraEArsyesSëPavlefshmërisë* (VoidReasonValue), e cila përmban:

- **E panjohur** (Unknown)

-- Përkufizimi --

Vlera korrekte për këtë element gjeohapësinor nuk njihet ose është e pamatshme nga krijuesi i të dhënave.

-- Përshkrim --

SHEMBULL: Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi uhor nga niveli i detit” e një liqeni të caktuar, nuk është matur, atëherë arsyeja e pavlefshmërisë së kësaj karakteristike mund të jetë “E panjohur”.

- **E papopulluar** (Unpopulated)

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë nuk është pjesë e databazës së mirëmbajtur nga krijuesi i të dhënave. Pavarësisht kësaj kjo e dhënë mund të ekzistojë.

-- Përshkrimi --

SHEMBULL: Kur “kuota e sipërfaqes së një trupi uhor nga niveli i detit” nuk është e përfshirë në grupin e të dhënave që përmban objektin gjeohapësinor të liqenit, atëherë vlera e kësaj karakteristike mund të jetë “E pa populluar”

- **Konfidenciale** (Withheld).

-- Përkufizimi --

Kjo karakteristikë mund të ekzistojë por është konfidenciale.

-- Përshkrimi --

SHEMBULL: Të dhënat personale të popullsisë, të cilat ekzistojnë, por që nuk mund të shfaqen pasi mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Stereotipi <<voidable>> nuk jep asnjë informacion nëse ekziston një karakteristikë në botën reale. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristikë mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 0. P.sh. nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. P.sh. nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 1..*.

2.2.4. MBULIMET - COVERAGES

Funksionet e mbulimit “Coverages” përdoren për të përshkruar karakteristikat e një fenomeni të botës reale që zhvillohet në kohë dhe /ose hapësirë. Shembuj tipikë të tyre janë temperaturat, lartësitë, imazheritë etj. Një mbulim përmban një grup vlerash, të cilat shoqërohen me një element gjeohapësinor, kohor, kohor - gjeohapësinor. Domein-et tipike gjeohapësinore janë grupe pikash (p.sh. vendndodhja e sensorëve), kurbat përcaktuese (p.sh. izolinjat), rrjetet (p.sh. ortoimazheria, modelet e lartësive) etj.

Në skemat e aplikimit të INSPIRE, funksionet e mbulimit janë përcaktuar si veti të llojeve të objekteve gjeohapësinore, ku lloji i vlerës së kësaj karakteristike është realizim i një prej llojeve të specifikuara në SSH EN ISO 19123:2007.

Për të përmirësuar përputhjen me standardet e mbulimit në nivelin e zbatimit (p.sh. ISO 19136 dhe OGC Shërbimi i Mbulimit në Internet) dhe për të përmirësuar harmonizimin ndër-tematik, për përdorimin e mbulimeve në INSPIRE, një skemë e aplikimit për llojet e mbulimit është përfshirë në Modelin Konceptual të Përgjithshëm “Generic Conceptual Model”.

Kjo skemë aplikimi përmban llojet e mëposhtme të mbulimit:

- *RrjetiIMbulimitKorrigjuar (rektifikuar)*: Mbulimi, domein-i i të cilit përbëhet nga një rrjet i korrigjuar, një rrjet për të cilin ka një transformim përfundimtar midis koordinatave të rrjetit dhe koordinatave të sistemit koordinativ referencë. (shih figurën 2, djathtas, majtas).
- *RrjetiIMbulimitReferencë*: Mbulimi, domein-i i të cilit përbëhet nga një rrjet referimi, një rrjet i lidhur me një transformim që mund të përdoret për të kthyer vlerat e koordinatave të rrjetit në vlerat e koordinatave të referuara në një sistem referimi koordinativ (shih figurën 1, djathtas).

Aty ku është e mundur përdoren vetëm këto lloje mbulimi (ose një nëntip i tyre) në skemat e aplikimit në INSPIRE.




Figura 1 – Shembuj të një rrjeti të korrigjuar (majtas) dhe një rrjeti referues (djathtas)

2.2.5. NUMËRTIMET DHE KOD LISTAT (ENUMERATION AND KOD LISTË).

Kod listat modelohen si klasa në skemat e aplikimit, por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kod listë, ‘vlera të tjera’ përcaktojnë llojin e përmbajtjes së kod listës, e përcaktuar specifikisht si më poshtë:

- **‘jo’** përfaqëson kod lista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuara në këtë dokument.
- **‘të’** kufizuara përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.
- **‘të hapura’** përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë dokument dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.
- **‘po’** përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvendësojnë, apo të modifikojnë, vlerat ekzistuese, të përcaktuara në dokument.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kod lista me vlera “**jo**”, pra të specifikuar në dokument, ofruesit janë të detyruar t’i bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që edhe përdoruesit e tjerë t’i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t’i përdorin.

2.2.6. PARAQITJA E DIMENSIONIT KOHOR

Skemat e aplikimit përdorin atributin “*FillimiICiklitJetësor*” dhe “*PërfundimiICiklitJetësor*” për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti gjeohapësinor.

Atributi “*FillimiICiklitJetësor*” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave gjeohapësinoe (në sistem). Atributi “*PërfundimiICiklitJetësor*” specifikon datën kur versioni i objektit gjeohapësinor është zëvendësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave gjeohapësinoe (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin “*PërfundimiICiklitJetësor*” nuk shkaktjnë ndryshime në atributin “*FillimiICiklitJetësor*”.

❖ **Shënim i rëndësishëm:**

Disa terma në Katalogun e tipologjive, si p.sh. FeatureType, DataType, Void, Coverages etj, nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasin kuptimin gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të Direktivës INSPIRE.

2.3. DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të nenit 16, të ligjit Nr. 72/2012, “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë*”, ASIG është institucioni përgjegjës për krijimin e standardeve, për secilën nga temat e përcaktuara në nenin 11, të këtij ligji, në përputhje me standardet evropiane (Direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinoe, për krijimin e NSDI në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në Direktivën INSPIRE si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare që mbështesin dhe bazohen në këtë direktivë. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të zbatojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave gjeohapësinoe.

Standardet (Rregullat e implementimit - IR) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- **Metadata** – në këtë fushë direktiva përcakton standardet se si duhen të jenë metadatat. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjitha institucionet ose palët e treta (sikurse është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do të implementojnë atë. (VKM Nr. 1077, datë 23.12.2015)
- **Specifikimi i të dhënave** – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme që do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa attribute bazë të cilat do të shërbejnë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose të nevojave të brendshme, mund të shtojnë attribute të tjera për t’i bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të miratuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.4. FUSHA E VEPRIMIT

Të gjithë autoritetet publike, kompanitë private apo individë që mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të institucioneve publike, janë të detyruar t'i nënshtrohen këtij standardi.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga Direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor, si më poshtë:




Figura 2: Proceset e ciklit jetësor

Planifikimi – Është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

Vlerësimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do të jetë certifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat që të përshtaten me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

Procesimi (Përpunimi) – Është procesi gjatë të cilit mblidhen dhe modifikohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuara gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi janë bashkësi të dhënash gati për t'u publikuar.

Shpërndarja – Është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (qytetarët, autoritetet publike, organizatat ose palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, të përdorë, të analizojë ose të citojë të dhënat. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

Zbulimi – Është proces i vazhdueshëm gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jocosile në të dhënat e publikuara.

Analiza – Është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi çfarë do të bëhet me të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – Është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

Arkivimi – Është procesi gjatë të cilit bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen arkivohen duke u bazuar në standarde lokale dhe në legjislacionin në fuqi të vendit ku implementohet standardi. Rezultat i këtij procesi janë të dhënat që bëhen të pa aksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen, për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose me standardet specifike.

Shkatërrimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat bëhen të parikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde lokale ose në legjislacione në fuqi.

3. TEMA

3.1. INFRASTRUKTURA BUJQËSORE DHE AKUAKULTURA

3.1.1. PARATHËNIE

Specifikimi i të dhënave, për temën “*Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura*”, ka të bëjë me përshkrimin e të gjithë instrumentave fizikë dhe ndërtimorë me vendosje të përhershme ose gjysmë të përhershme (në brendësi apo jashtë vendit), që lidhen me aktivitetet bujqësore dhe akuakulturën. Kjo temë lejon përfshirjen e informacionit edhe për pjesë të kufizuara, të tokës dhe ujit, që lidhen me veprimtaritë bujqësore dhe akuakulturën, të cilat i nënshtrohen ligjit me leje të veçantë, monitorim ose menaxhim (“ngastër”). Gjithashtu kjo teme mbulon të gjitha kushtet që lidhen me aktivitetet bujqësore dhe akuakulturën për të cilat është e mundur të identifikohet një përfaqësues ligjor, për menaxhimin ose funksionimin e tyre.

Edhe pse tema “*Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura*” përfshin dy koncepte të ndryshme, të dyja qëllimet janë të përfshira në një model konceptual. *Modelimi konceptual* për Ndërmarrjen bujqësore është përcaktuar në të njëjtin nivel si dhe për Ndërmarrjen në akuakulturë duke qënë në gjendje të identifikohen përmes aktivitetit të kryer (atribut). I njëjti rregull është ndjekur edhe për nivelet e tjera të detajeve si instalimet. Specifikimi i të dhënave nuk përfshin informacion lidhur me fushat e menaxhimit që përfshijnë grupe të pronave, të klasifikuara sipas kriterëve të ndryshme (zona të prekura nga sëmundje) ose klasifikimi i tokës (planifikimi urban dhe rural). Specifikimi i të dhënave për këtë temë synon të sigurojë një kornizë të fortë për hartimin, raportimin dhe modelimin, e cila është e nevojshme për të mbështetur formulimin e politikave përmes raportimit më të mirë dhe menaxhimit të iniciativave pan-europiane, siç janë menaxhimi i mbetjeve, ujrave, lëvizjet e kafshëve, kontrolli epideminologjik, gjurmimi i ushqimit etj. Të dhënat e temës “*Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura*” përmbushin një funksion në lidhje me informacionin e objekteve në realitet. Kjo temë ka të bëjë me elementët fizik që lidhen me këto lloj aktivitetesh. Gjithashtu modeli konceptual mund të zgjerohet me kërkesat e mëtejshme të përdoruesve, që mund të identifikohen në të ardhmen.

Përkufizimi

Infrastruktura e pajisjeve bujqësore dhe të prodhimit (duke përfshirë sistemet e ujitjes, serrat dhe stallat).

Përshkrimi

Bujqësia i referohet grupit të procesit dhe aktiviteteve që përbëhen nga kultivimi i tokës, të korrat e prodhuara (prodhimi i kulturave të ndryshme) dhe rritja e kafshëve; përfshin vjeljen, mjeljen, mbajtjen e kafshëve për qëllime bujqësore, mbajtjen e tokës në gjendje të mirë bujqësore dhe mjedisore. Gjithashtu objekte që variojnë nga të gjitha ndërmarrjet në instalime të tilla si sistemet e ujitjes, serrat, stallat, hangarët, rezervuarët.

Akuakultura mbulon aktivitetet dhe teknikat që lidhen me prodhimin, kultivimin dhe trajtimin e peshqve, molusqeve, algave dhe llojeve të tjera të burimeve ujore (bimët ose kafshët). Infrastruktura e akuakulturës përfshin vetëm sisteme të përhershme ose gjysmë të përhershme ose ndërtime për mbarëshkrimin, trajtimin dhe ngritjen e organizmave. Infrastruktura e akuakulturës mund të ekzistojë edhe në ujërat detare, në mjediset e ujrave të brëndshme, si dhe në sisteme të prodhimit tokësor.

Kapja, gjuetia ose mbledhja e burimeve natyrore (bimë ose kafshë) në mjedisin e tyre natyror nuk konsiderohet si aktivitet bujqësor, përveç nëse mbështetet nga instrumentet fizikë dhe ndërtimorë përkatës. P.sh. pylltaria nuk konsiderohet si një aktivitet bujqësor, me përjashtim të pemëve (tree nurseries).

Qëllimi i grupit teknik të punës për përgatitjen e temës "Infrastrukturës Bujqësore dhe Akuakultura" i referohet të gjithë instrumentave fizikë dhe të ndërtimit, me vendosje të përhershme ose gjysmë të përhershme (në brendësi apo jashtë vendit), që lidhen me aktivitetet bujqësore dhe akuakulturën. Në të përfshihen:

- A - Agrikultura, pylltaria dhe peshkimi
- A1 - Prodhimi i bimëve dhe kafshëve, gjuetia dhe aktivitetet e lidhura me shërbimin
- A1.1 - Rritja e kulturave jo-shumëvjeçare
- A1.2 - Rritja e kulturave shumëvjeçare
- A1.3 - Përhapja e bimëve
- A1.4 - Prodhimi i kafshëve
- A1.5 - Bujqësia e përzierë
- A1.6 - Mbështetja e aktiviteteve për bujqësinë dhe aktivitetet pas kultivimit të korrjes
- A3 - Peshkimi dhe akuakultura
- A3.2 - Akuakultura
- A3.2.1 - Akuakultura Detare
- A3.2.2 - Akuakultura e ujrave të ëmbla

Veprimtaritë e renditura më poshtë, siç janë kapja, gjuetia, peshkimi ose grumbullimi i burimeve natyrore (bimët ose kafshët), në mjedisin e tyre natyror mund të përfshihen në kuadër të fushës kur mbështetet nga instrumentet fizike dhe ndërtimore, por gjithnjë e kufizojnë informacionin e tyre siç kërkohet në specifikimet e të dhënave. Subjektet që i referohen zonave të zgjeruara duhet të konsiderohen në temat më të përshtatshme si (*Njësitë Statistike, Parcela Kadastrale* etj). Këto mund të jenë:

- A3.1 - Peshkimi
- A3.1.1 - Peshkimi detar
- A3.1.2 - Peshkimi në ujra të ëmbël
- A1.7 - Gjuetia, peshkimi dhe aktivitetet e lidhura me shërbimin
- A1.7.0 - Gjuetia, peshkimi dhe aktivitetet e lidhura me shërbimin
- A2 - Pylltaria dhe prerjet
- A2.1 - Pylltaria (Silvikultura) dhe aktivitete të tjera pyjore
- A2.1.0 - Pylltaria (Silvikultura) dhe aktivitete të tjera pyjore
- A2.2 - Prerjet
- A2.2.0 - Prerjet
- A2.3 - Mbledhja e prodhimeve, jo druri në rritje të egër
- A2.3.0 - Mbledhja e prodhimeve, jo druri në rritje të egër
- A2.4 - Shërbimet mbështetëse për pylltarinë
- A2.4.0 - Shërbimet mbështetëse për pylltarinë

Nën fushëveprimin e bujqësisë dhe akuakulturës, "Infrastruktura" konsiderohet si një term i përgjithshëm që i referohet strukturave fizike ose grupeve të tyre të projektuara, të ndërtuara ose të instaluar për t'i shërbyer një funksioni të veçantë (bujqësisë ose akuakulturës) dhe sipërfaqeve të tokës ose ujit ku struktura

të tilla janë/ose mund të vendosen. Bazuar në këtë përkufizim të përgjithshëm, fushëveprimi mbulon një gamë të gjerë entitetesh nga *Ndërmarrjet* tek *Instalimet Abstrakte* (Njësitë Specifike Teknike).

“Infrastruktura” dedikuar ruajtjes optimale të materialeve që lidhen ose përfitohen drejtpërdrejt nga aktivitetet e bujqësisë ose akuakulturës, vendoset brenda kufijëve të “*Vendit*” dhe të “*Ndërmarrjes*” në të cilën këto materiale që janë prodhuar janë të mbuluara nga fushëveprimi (p.sh. rezervat e qumështit të papërpunuar). “Infrastruktura” që lidhen me Aktivitetet e marketingut dhe transformimit të lëndëve të para në produkte të përpunuara në mënyrë industriale, do të ishin në kuadër të temave të tjera, rast i ngjashëm ndodh për ato aktivitete të kryera në ndërmarrjet bujqësore por jo që lidhen drejtpërdrejtë me veprimtaritë bujqësore dhe akuakulturës siç janë përshkruar dhe pa ndikim të rëndësishëm në mjedis (p.sh. strehimi i personave ose aktivitetëve rekreative).

E gjithë “Infrastruktura” ku kafshët edukohen ose mbahen, për përdorime që nuk lidhen drejtpërdrejtë me aktivitetet e bujqësisë ose akuakulturës, do të ishin brënda qëllimit nëse grupet ekzistuese, të lidhura me bujqësinë ose akuakulturën, i përfshijnë ato për shkak të qëllimeve të tyre (p.sh. me qëllim të kontrollit epidemiologjik të sëmundjet e kafshëve, mund të përfshihen qendrat e kuajve).

Të gjithë instrumentet fizike dhe ndërtimore që janë pjesë e peisazhit rural, por që nuk lidhen ligjërisht me pronat specifike të bujqësisë ose akuakulturës (palët përgjegjëse - operatori) mund të përfshihen në kuadër të qëllimit, por gjithmonë kufizojnë informacionin e tyre, siç kërkohet në Specifikimet e të Dhënave.

Shembuj:

Ndërmarrjet bujqësore dhe akuakultura (shtesa *Aktiviteti Kompleks*), janë veprimtari njerëzore që ndodhin mbi territorin, lidhen drejtpërdrejt me mjedisin në të cilin ndodhen (toka, uji dhe ajri); në këtë kontekst, ato janë subjekt i legjislacionit të ndryshëm (nga Lokal në Evropian).

Si *Aktivitetet ekonomike*, ato i nënshtrohen një game të gjërë legjislacioni të përbashkët që rrjedhin nga operacionet e tyre (mbeturina, uji, etj.). Rastet e përdorimit dhe shembujt në bazë të kësaj mund të jenë p.sh. përkufizimi i “Planeve të menaxhimit të mbeturinave” ose “përcaktimi i zonave të kujdesit të veçantë” ose “ndjeshmërisë lidhur me burime të ndryshme të rrezikut” (p.sh. radioaktiviteti bërthamor ose emetimet kimike).

Si burim i ushqimit për konsumim, të gjitha këto objekte janë gjithashtu subjekt i një game të gjerë të legjislacionit sanitar dhe të menaxhimit dhe kujdesit të kafshëve (gjurmshmeria, shëndeti i kafshëve, regjistri i kafshëve, etj).

Aktivitetet që ndodhin drejtpërsëdrejti mbi mjedisin, nxjerrjen dhe konsumimin e burimeve nga to (toka, uji), gjithashtu i nënshtrohen legjislacionit që kontrollon përdorimin e burimeve dhe përdorimin e substancave të caktuara (nitrat, ujitje, plehërim, etj).

Atributet dhe tipologjitë e rëndësishme:

Ndërmarrjet e Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura, pavarësisht nga përdorimi i tyre, mund të kenë një pozicion të saktë dhe fikse (pikë, vijë, zonë).

Vendndodhja e ndërmarrjeve mund të ekzistojë si koordinata, ose indirekt përmes adresës, pronës (informacioni kadastral) ose ndërtesave. Përdorimi i GIS-eve ose shërbimeve të internetit, mund të bashkojnë bazën e të dhënave të tyre dhe bazën e të dhënave që ofrojnë mundësi për referim indirekt.

Objektet (gjërat ose ndërtimet) mund të shprehen si informacion gjeohapësinor, si pika ose poligone, në varësi të shkallës. Infrastrukturat lineare mund të shprehen si rrjete (hark-nyje). Parcelat duhet të përshkruhen si poligone (sipërfaqe).

3.1.2. SKEMAT E APLIKIMIT DHE DIAGRAMA UML PËR TEMËN “INFRASTRUKTURA BUJQËSORE DHE AKUAKULTURA”

Modeli konceptual i temës “*Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura*” është i përbërë nga informacionet bazë në lidhje me përshkrimin gjeografik të subjekteve, nën fushëveprimin e bujqësisë dhe akuakulturës. Ajo është bazuar në tipologjinë e *AktivitetetKomplekse*, ku modeli i *AktivitetetKomplekse* shtrihet në tipologjitë bazike të bujqësisë dhe akuakulturës, që janë *Ndërmarrjet* dhe *Vendet*. Këto tipologji përmbajnë vetëm informacionin bazë për vendndodhjen e ndërmarrjeve dhe vendeve, llojin e aktiviteteve të kryera në atë vend, dhe vetëm në rastin kur mbahen kafshët, përshkruajnë çfarë lloj kafshësh mbahen në këtë vendndodhje.

Një ndërmarrje konsiderohet si një specializim i një *AktivitetetKomplekse*. Çdo *Aktivitet kompleks* – *Ndërmarrje* përmban të paktën një ose shumë vende. Në një zonë mund të mbahen kafshë. Një zonë tjetër, asnjë, një ose më shumë lloje kafshësh, të cilat nuk mund të regjistrohen.

Pozicioni i një *Ndërmarrje* dhe *Vendi* mund të paraqitet me pikë ose sipërfaqe (poligon).

Aktivitetet e ndërmarrjeve dhe vendeve paraqiten duke përdorur klasifikimin nga standardet NACE² të përcaktuara nga BE.

Datatype *LlojetEKafshëveTëFermës* paraqitet duke përdorur kodlistat e standardit për speciet e kafshëve blegtorale dhe kodlistat e standardit “Organizata botërore e ushqimit” (FAO) për speciet e akuakulturës.

- **Aktivitetet Komplekse:** E gjithë zona dhe të gjitha infrastrukturat e saj, janë nën kontrollin e operatorit. Në temën “*Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura*”, Aktivitetet Komplekse paraqiten si ndërmarrje.
- **Ndërmarrje:** E gjithë zona dhe e gjithë infrastrukturat e përfshira në të, që janë nën kontrollin e një operatori, për të kryer aktivitetet bujqësor dhe të akuakulturës. Ajo mund të përbëhet nga një ose më shumë “Vendndodhje”.

Ky koncept lidhet me të gjithë informacionin e përbashkët që zbatohet mbi të gjitha subjektet e ndryshme që lidhen me aktivitetet bujqësore dhe akuakulturën ose aktivitetet që janë nën përgjegjësinë e një operatori ligjor. Ajo mund të konsiderohet si përfaqësim sintetik gjeografik i një organi unik operativ, ekonomik apo juridik.

² NACE - Statistical Classification of Economical Activities in Europe – Klasifikimet Statistikore të Aktiviteteve Ekonomike në Europë

- Vendndodhja: Përkatësia e një ndërmarrjeje, është përfaqësimi gjeografik i tokës që përmban një njësi menaxhuese. Ajo përfshin të gjithë infrastrukturën, pajisjet dhe materialet.

Koncepti i “Vendodhjes” lidhet me sipërfaqe poligonale. Përkufizimi dhe qëllimi i tij rrjedhin nga përkufizimi ligjor i “Vendodhjes” ku termi është përshkruar si:

E gjithë toka në një vendodhje të veçantë gjeografike, nën kontrollin e menaxhimit të një operatori.

E gjithë toka në një vendndodhje të veçantë gjeografike, nën kontrollin e menaxhimit të një organizate, që mbulon aktivitetet, produktet dhe shërbimet. Kjo përfshin të gjitha pajisjet dhe materialet e infrastrukturës.

Të gjitha "Ndërmarrjet" duhet të lidhen së paku me një "Vendndodhje", por një "Ndërmarrje" mund të menaxhojë një ose më shumë "Vende".

Shtrirja gjeografike e “Vendndodhjes” është përshkruar si *GM_Objekt* për të lejuar përfaqësimin e saj si një pikë (trashëguar nga mbajtja) ose përfaqësimi më kompleks si një Grup i Poligoneve të izoluara (*Multisurface*). Topologjikisht të gjitha pjesët e tjera të elementëve gjeografike duhet të përfshihen nën kufijtë e një “Vendndodhje”. Nëse është e nevojshme një “Vendndodhje” mund të krijohet për të përfshirë secilën prej këtyre nën-elementëve përfaqësuese.

- Llojet e kafshëve të fermave: është një *DataType* që lidhet me “Vendndodhje” i cili lejon për të përshkruar praninë e kafshëve në të.




Figura 3: Diagrama Uml: Përshkrimi i featureType dhe dataType të Modelit të skemës së aplikimit të temës “Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura”




Figura 4: Diagrama Uml: Përshkrimi i codlistave të Modelit të skemës së aplikimit të temës “Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura”

Përfaqësimi gjeografik i temës “Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura” duhet të konsiderohet si i pavarur. Kjo do të thotë që njësitë e përshkruara duhet të kenë përkufizimin e tyre gjeografik. Megjithatë në shumicën e rasteve mund të krijohet një lidhje e drejtpërdrejtë me elementë të tjerë gjeografikë, kjo lidhje mund të bëhet burim i gabimeve, në saktësinë e gjeopozicionit, të elementëve të përfshira në grupin e të dhënave.

Në brendësi, informacionet që lidhen me të njëjtën “Infrastrukturë”, ose elemente të përfshira në to, mund të ekzistojnë të izoluar në grupe të ndryshme të dhënash nga institucione të ndryshme ose ofruesit e të dhënave. Të gjitha këto informacione duhet të unifikohen në mënyrë që të shmangen dublikimet ose tejkalimet e informacionit. Çështje tjetër e rëndësishme është ruajtja e marrdhënieve topologjike midis subjekteve kryesisht në ato të ofruara nga burime të ndryshme (ofruesit e të dhënave).

Specifikimet e të dhënave të temës “Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura” përdorin tipin e të dhënave të Identifikuesit nga Modeli konceptual i përgjithshëm. Këto identifikues përfshijnë numrin e versionit, kështu që ato mund të përdoren për të gjetur ndryshimet në një objekt.

Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura i nënshtrohet një sërë identifikuesish që varen nga zbatueshmëria e grupeve të të dhënave në të cilat përfshihen fillimisht (regjistrimi ligjor, regjistri i bazuar në legjislacion, etj ...). Duke u bazuar në këtë shumëllojshmëri, është mjaft e vështirë të harmonizohet një kriter me qëllim që të shmanget dyfishimi. Për këtë arsye, duke u bazuar në zbatueshmërinë e shtresave, në rastet specifike të përdorimit, modeli ka përfshirë identifikuesit vetëm në nivelin e Aktivitetet Komplekse - Ndërmarrjen. Në nivelet unike të Vendndodhjes identifikuesit nuk implementohen.

Nëse ofruesit e të dhënave zgjedhin të zbatojnë referencat e objekteve të jashtme, për llojet e objekteve gjeohapësinore, në tema të tjera, ato duhet të sigurojnë që mekanizmat e përditësimit të jenë në vend për të siguruar përputhshmëri midis referencave të objekteve.

Në përgjithësi, informacionet gjeografike (grupet e të dhënave) duhet të sigurohen nga organizata të ndryshme (administrata publike dhe private) që kanë të bëjnë me Infrastrukturën bujqësore dhe

akuakulturën, duke ju referuar të paktën pozitës gjeografike të “Ndërmarrjeve” kryesore si “pikat” pavarësisht nga niveli i detajeve.

Për legjislacionin më të përgjithshëm kërkohet informacioni gjeografik në koordinata gjeografike (X,Y). Në raste të caktuara, pozicioni gjeografik mund të vlerësohet përmes procesit automatik, përmes “Adresës” të parashikuar në formularët e regjistrimit. Ky lloj aktiviteti mund të rrjedhë në vendodhjen e gabuar gjeohapësinore, si rezultat i informacionit burimor të dhënë (p.sh. adresa ligjore në vend të adresës së objektit). Një proces pastrimi mbi grupet e të dhënave duhet të garantojë saktësinë e gjeologjimit të subjekteve.

Në rastin e “Ndërmarrjeve” të përbëra nga “Vendndodhje” të ndryshme, jo të vazhdueshme gjeografikisht, do të ishte e vlefshme për të siguruar informacionin gjeografik që lidhet me atë kryesor. Nuk do të ishte e vlefshme, nëse mungesat ndërmjet vendeve të ndryshme janë përfaqësuese, duke përcaktuar pozicionin si një “centroid” të të gjithë atyre si gjeo-përfaqësim.

Nëse elementi *GM_Objekt* zbatohet si *GM_Multisurface*, kjo përfshin që të gjitha “Vendndodhjet” e ndryshme të ndajnë të gjitha atributet. Kjo duhet të merret në konsideratë kur përshkruhen *SpecietEKafshëveTëFermës*.

Në disa raste që lidhen me aktivitetet bujqësore dhe akuakulturën, që mbulojnë një shtrirje përfaqësuese të tokës (detare ose tokësore), “Vendndodhja”, kjo mund të sigurohet si përfaqësim gjeografik më i hollësishëm i “Ndërmarrjes”, që përshkruhet si poligon (2D) në grupin e të dhënave Rajonale – Lokale. Në disa raste të veçanta kemi edhe modelin konceptual shtesë. “Vendndodhja” ose poligonet në të cilin vendosen element të tjerë të përfshirë në model, mund të lidhen me parcela kadastrale, por kjo lidhje duhet të jetë mjaft komplekse nga pikëpamja ontologjike dhe nuk është konsideruar.

Një tjetër lloj informacioni i gjeo-referuar kërkohet sipas legjislacionit të përfshirë në dokumentet dhe përshkrimet e kërkuara pa referenca në formate specifike. Ky opsion mund të zgjidhet vetëm me elemente jashtë (si URL-të) ose në përfshirjen e shtresave raster (jashtë fushës).

Modeli është i përhapur për elemente të tjerë të detajuar të përfshirë në “Ndërmarrje” (p.sh. Instalimet, Njësitë teknike). Këto elemente duhet të përfaqësohen nga subjektet gjeografike të lidhura topologjikisht me “Vendndodhjet”. Në të njëjtat raste, përfaqësimi gjeografik mund të jetë i përputhshëm dhe i trashëguar nga niveli më i lartë hierarkik, të cilit ata i përkasin.

3.1.3. KATALOGU I TIPOLOGJISË

3.1.3.1. NDËRMARRJE

-- Emri --

Ndërmarrje

-- Përkufizimi --

E gjithë zona, bashkë me infrastrukturën e përfshirë në të, që mbulojnë "Vendndodhje" të njëjta ose të ndryshme, nën kontrollin e një operatori për të kryer aktivitete bujqësore ose të akuakulturës. Mbajtja përfshin një specializim të *AktivitetetKomplekse*, dmth. *Aktiviteti*, vlerat e aktivitetit janë shprehur në përputhje me klasifikimin e veprimtarisë ekonomike të pronës, të gjithë zonën dhe të gjitha infrastrukturat e përfshira në të, duke mbuluar "Vendndodhje" të njëjta ose të ndryshme, nën kontrollin e një operatori për të kryer aktivitete bujqësore ose të akuakulturës. Mbajtja përfshin një specializim të *AktivitetetKomplekse*, dmth. *Aktiviteti*, vlerat e aktivitetit tip janë shprehur në përputhje me klasifikimin e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes, sipas NACE rev. 2.0 kodim. Ndërmarrjet janë një shtrirje tematike e klasës gjenerike "Aktivitetet Komplekse" i ndarë me fusha të tjera tematike, që përshkruajnë entitetet që lidhen me Aktivitetet Ekonomike (Klasa e Subjektit Ligjor - Biznes). Ndërmarrja është një shtrirje tematike e klasës gjenerike "Aktivitetet Komplekse", e ndarë me fusha të tjera tematike që përshkruajnë entitetet që lidhen me Aktivitetet Ekonomike (Klasa e Subjektit Ligjor - Biznes).

-- Përshkrimi --

E disponueshme në arkivin e Eurostat nga URL

<http://ec.europa.eu/eurostat/ramon/nomenclatures/index.cfm?>

TargetUrl = LST_CLS_DLD & StrNom = NACE_REV2

& StrLanguageCode = EN & StrLayoutCode = hierarkike.

Kodet e vlefshme janë:

kodet e nivelit të parë:

01 dhe 03

kodet e nivelit të dytë:

01.1 - 01.6 dhe 03.2

dhe kodet e nivelit të tretë:

01.11 - 01.64 dhe 03.21 - 03.22

Kodet e ardhshme nga diapazoni 01 deri në 03.22 përjashtohen:

01.7 kapja e gjuetisë së një shërbimi përkatës;

02. pylltaria dhe prerjet;

03.1 peshkimi

--Tipi i elementit--

FeatureType




LIDHJE STRUKTURE TË JASHTME

← Gjeneralizuar nga <featureType> *Ndërmarrjet* tek <featureType> *Ndërmarrjet*

ATTRIBUTE

◆ KapacitetiFizik : Kapaciteti

Shumëllojshmëria: [0..*]

ATTRIBUTE
<p>-- Emri -- Kapaciteti fizik</p> <p>-- Përkufizimi -- Një kuantifikim i një aftësie aktuale ose potenciale për të kryer një aktivitet, që zakonisht nuk ndryshon, nuk ndryshon shpesh ose nuk ndryshon në një shkallë të konsiderueshme.</p> <p>-- Përshkrimi -- Shënim: Kapaciteti mund t'i referohet koncepteve të ndryshme të përfshira në legjislacion si "kufiri i shkarkimeve", "djegia e kapaciteteve", "kapaciteti nominal", "vlerësimi objektiv".</p> <p style="text-align: right;">[I detyrueshëm:PO]</p>
<p> Leje : Leje Shumëllojshmëria: [0..*]</p> <p>-- Emri -- Leje</p> <p>-- Përkufizimi -- Vendimi Zyrtar (miratimi formal) që lejon autorizimin për të operuar të gjitha ose një pjesë të një ndërmarrje, në varësi të kushteve të caktuara të cilat garantojnë që instalimi ose pjesët e instalimeve në të njëjtin vend të operuar nga i njëjti operator që përputhen me kërkesat e përcaktuara me ligj ose me standardet. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë funksione dhe të rregullojë parametrat e kapacitetit; Afati mund të shtrihet në çertifikata të tjera ose dokumente me rëndësi të veçantë në varësi të qëllimit (p.sh. ISO, EMAS, Standardet Kombëtare të Cilësisë etj).</p> <p>-- Përshkrimi -- Shënim: Ky term i referohet disa akteve legislative si "leje", "autorizim", "miratim zhvillimi" ose "leje eksplorimi" etj. Shëmbull 1: një vendim [me shkrim] me të cilin autoriteti kompetent jep lejen për të operuar të gjithë ose një pjesë të një instalimi "; Shëmbull 2: ose vendimi i autoritetit kompetent.</p> <p style="text-align: right;">[I detyrueshëm:PO]</p>
<p> PërshkrimiINdërmarrjes: PërshkrimiIAktivitetitKompleks Shumëllojshmëria: [0..1]</p> <p>-- Emri -- Përshkrimi i ndërmarrjes</p> <p>-- Përkufizimi -- Informacione shtesë për një ndërmarrje, duke përfshirë adresën, një kontakt, palët e ndërlidhura dhe një përshkrim të lirë teksti.</p> <p style="text-align: right;">[I detyrueshëm:PO]</p>
<p> StatusiINdërmarrjeve : Public Shumëllojshmëria: []</p> <p>-- Emri -- Statusi i ndërmarrjeve</p>

ATTRIBUTE
-- Përkufizimi --

Statusi i ndërmarrjeve, të tilla si operative ose të çmontuara.

[I detyrueshëm:PO]

3.1.3.2. VENDNDODHJE
-- Emri --

Vendndodhje

-- Përkufizimi --

Të gjitha zonat, në një vend gjeografik, të njëjtë ose të veçantë, nën kontrollin e menaxhimit të një ndërmarrjeje që mbulon aktivitetet, produktet dhe shërbimet. Kjo përfshin të gjithë infrastrukturën, pajisjet dhe materialet. Gjeometria e vendndodhjes duhet të jetë një pikë ose një sipërfaqe. Nuk është e lejuar pikëpamja *Multipoint* ose *multisurface*.

-- Përshkrimi --

Vendndodhja mund të paraqitet me pikë ose sipërfaqe, si dhe mund të ketë vetëm gjeometrinë.

--Tipi i elementit--

FeatureType

LIDHJE STRUKTURORE TË JASHTME

← Agreguar nga «featureType» *Vendndodhje* tek «featureType» *Ndërmarrje*

Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --

Vendndodhja e ndërmarrjes

-- Përkufizimi --

Vendndodhjet që janë pjesë e ndërmarrjeve të specifikuara.

[I detyrueshëm:PO]

ATTRIBUTE

♦ Aktiviteti : VleratNACETëAktivitetitEkonomik

Shumëllojshmëria: [1..*]

-- Emri --

Aktiviteti

-- Përkufizimi --

Klasifikimi i aktivitetit ekonomik të vendndodhjes, sipas NACE rev. 2.0 kodim.

-- Përshkrimi --

ATTRIBUTE

E disponueshme në arkivin e Eurostat nga URL
[http://ec.europa.eu/eurostat/ramon/nomenclatures/index.cfm?TargetUrl=LST_CLS_DLD & StrNom = NACE_REV2 & StrLanguageCode = EN & StrLayoutCode = hierarkike.](http://ec.europa.eu/eurostat/ramon/nomenclatures/index.cfm?TargetUrl=LST_CLS_DLD&StrNom=NACE_REV2&StrLanguageCode=EN&StrLayoutCode=hierarkike)

Kodet e vlefshme të qarqeve janë:

Niveli i parë

01 dhe 03


niveli i dytë

01.1 - 01.6 dhe 03.2

niveli i tretë

01.11 - 01.64 dhe 03.21 - 03.22

[I detyrueshëm:PO]

 Gjeometri : GM_Object

Shumëllojshmëria: [1]

-- Emri --

Gjeometria

-- Përkufizimi --

